

UBT-PRISHTINA

Nr. 2631 Data 06.03 2026



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT  
ZYRA E KRYEMINISTRIT - RED PREMIER'S OFFICE OF THE PRIME MINISTER  
INSTITUTI I KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË

Dalëse

Nr. / Br. / No. 011.154

Nr. i faq / Br. str / No. pg 4

Data/Datum/Date 06.03.2026

Prishtinë / Priština / Pristina

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NË MES TË

INSTITUTIT TË KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË

DHE

UNIVERSITETIT PËR BIZNES DHE TEKNOLOGJI (UBT)

Prishtinë, Mars 2026

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Ky Memorandum i Bashkëpunimit ka për qëllim përcaktimin e bashkëpunimit në mes të Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm: Instituti) dhe Kolegjit UBT (në tekstin e mëtejshëm: UBT) në fushën e zhvillimit të projekteve hulumtuese, organizimit të konferencave, seminareve, dhe aktiviteteve të tjera për ndarjen e burimeve dhe ekspertizës për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me interes të ndërsjellë.

## **Neni 2**

### **Synimi**

Palët do të kenë bashkëpunim të ndërsjellë, dhe përmes aktiviteteve të përbashkëta do të ndihmojnë kauzën e ballafaqimit me të kaluarën dhe edukimin e angazhimin e të rinjve në këtë aspekt.

## **Neni 3**

### **Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

1. Palët do të bashkëpunojnë lidhur me një gamë të gjerë aktiviteteve dhe iniciativash me interes të ndërsjellë për ofrimin e ekspertizës dhe njohurive brenda fushave të tyre përkatëse të kompetencës, përfshirë, por pa u kufizuar në:
  - 1.1. Planifikimi i përbashkët i aktiviteteve në zhvillimin e programeve të ndryshme edukative që ndërlidhen me historinë dhe dëmet e krimeve të luftës në Kosovë;
  - 1.2. Bashkëpunimi dhe mbështetja profesionale në procesin e digjitalizimit dhe aplikimin e programeve specifike për nevojat hulumtuese, dokumentuese dhe arkivistike të IKKL-së;
  - 1.3. Ndarja e burimeve dhe ekspertizës të stafit akademik dhe studentëve, duke përfshirë qasjen në bibliotekat dhe arkivat e Institutit, për të mbështetur hulumtime dhe projekte që ndërlidhen me historinë dhe pasojat e krimeve të luftës në Kosovë;



1.4. Organizimi i aktiviteteve edukative, si konferenca dhe punëtori, tryeza të diskutimit dhe punëtori, për të nxitur ndërgjegjësimin mbi çështjet e krimeve të luftës;

1.5. Iniciativa të përbashkëta për bashkëpunim ndërkombëtar, duke përfshirë kërkimin e partneritetit edhe me institucione dhe organizata të tjera rajonale dhe ndërkombëtare.

2. Iniciativat konkrete dhe modalitetet e zbatimit të tyre dhe burimet financiare, si dhe aspektet e tjera, do të përcaktohen veçmas dhe sipas secilit rast veç e veç.

#### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja**

Ky Memorandum i Bashkëpunimit do të zgjasë katër (4) vite nga data e nënshkrimit nga palët nënshkruese. Kohëzgjatja e Memorandumit do të vazhdohet me automatizëm edhe për katër vite të tjera, nëse palët nënshkruese nuk kërkojnë ndryshe.

#### **Neni 5**

#### **Ndërprerja**

1. Ky Memorandum i Bashkëpunimit do të ndërpritet:

1.1. Me paralajmërim të arsyetuar me shkrim, së paku 30 ditë para datës së ndërprerjes së Memorandumit;

1.2. Me përfundimin e afatit kohor për të cilin është lidhur Memorandumi.

#### **Neni 6**

#### **Ekzemplarët e memorandumit**

Ky Memorandum i Bashkëpunimit nënshkruhet në dy (2) ekzemplarë të njëjtë, nga një ekzemplarë për secilën palë.

**Neni 7**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.

**Palët nënshkruese**

**Prof. Ass. Dr. Atdhe Hetemi**



**Drejtor Ekzekutiv, IKKL**

**Prof. Dr. Edmond Hajrizi**

**Rektor, Kolegji UBT**

Prishtinë, më 05-05.2026